

**AKT THEMELIMI
SHOQËRIA TREGTARE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“CANI NDËRTIM” SHPK.**

Sot në Tiranë, më 12.10.2023, bazuar në legjislacionin shqiptar, me vullnetin tim të lirë, jam shprehur në nënshkrimin si ortak themelues dhe deklaroj se kam përpiluar si më poshtë Aktin e Themelimit të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar “**CANI NDËRTIM**” SHPK.

Unë ortaku i vetëm Niko CANI, i datëlindjes 17.05.1982, lindur në Lapardha, Berat dhe banues në Tiranë në adresën: Rruga Migjeni, Nd.31, H.1, Yzberish, Kashar, i identifikuar nëpërmjet letërnjoftimin me numër personal I20517267N, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar:

THEMELIMI

Neni 1

Themelohet Shoqëria tregtare “CANI NDËRTIM” SHPK, e cila do ti nënshtronhet legjislacionit të Republikës së Shqipërisë në fuqi. Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj në bazë të këtij Akti Themelimi dhe Statutit të Shoqërisë.

SELIA E SHOQËRISË

Neni 2

Selia e shoqërisë tregtare “CANI NDËRTIM” SHPK do të jetë në adresën: Rruga Migjeni, Nd.31, H.1, Yzberish, Kashar, TIRANË.

Neni 3

Shoqëria tregtare mund ta ushtrojë veprimtarinë e saj në të gjithë juridikcionin territorial të Republikës së Shqipërisë, si dhe jashtë Shtetit.

Shoqëria mund të krijojë seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqipërisë dhe jashtë saj. Njësitë vartëse të shoqërisë jashtë shtetit do të krijohen nëse kjo e drejtë parashikohet dhe lejohet nga legjislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

OBJEKTI I SHOQËRISË

Neni 4

Import-eksport, Punime të specializuara ndërtimi që kryhen edhe me nënkontraktorë. Veshja e mureve me sistem kapot, hidroizolim i taracave, shtrim me parket dhe të tjera veshje druri të dyshemeve, veshja e murit me elementë druri. Veshje të dyshemesë me mokete dhe linoleum, përfshirë gomën ose plastikën. Veshje muri me terakotë, mermer, granit ose gurë, veshje me letër muri. Montimi i strukturave metalike dhe shtrim i tullave dhe vendosja e gurëve. Ngritja e oxhakëve dhe skeleri e platforma pune për ngrohje dhe çmontim skelash. Ndërtim i pishinave të zbuluara dhe pastrim me avull, gryerja me rërë dhe punime të ngjashme për fasadat e ndërtesave. Punime hidraulike, instalime të ngrohjes dhe kondicionimit të ajrit.

Neni 5

Me vendim të organeve vendimarrëse të shoqërisë, Shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar edhe në drejtime të tjera, kur ato janë në interes së mbarëvajtjes së aktivitetit të shoqërisë.

KAPITALI I SHOQËRISË

Neni 6

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100,000 (Njëqindmijë lekë), kapital i cili formohet dhe do të jetë në vlerë monetare. Shuma e kapitalit themeltar do të depozitohet në një llogari bankare në emër të shoqërisë në një prej bankave të nivelit të dytë që zhvillojnë aktivitetin në Republikën e Shqipërisë



KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të veprimtarisë së shoqërisë është pa afat dhe fillon nga data e regjistrimit të saj si person juridik pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të ndryshojë me vendim kohëzgjatjen e ushtrimit të veprimtarisë dhe ky vendim depozitohet menjëherë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit

DREJTIMIT I SHOQËRISË

Neni 8

Veprimtaria e shoqërisë tregtare "CANI NDËRTIM" SHPK do të drejtohet nga Administratori i saj z. Niko CANI për një periudhë 5-vjeçare, me të drejtë rizgjedhje.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakut të Vetëm ka të drejtë të emerojë një administrator tjeter, nëse e gykon të nevojshme.

Neni 9

Administratori i shoqërisë ka të drejtë të punësojë persona të ndryshëm në funksion të zhvillimit të veprimtarisë së shoqërisë

Neni 10

Shoqëria tregtare "CANI NDËRTIM" SHPK do të ketë vulën e saj, në të cilën shkruhet emërtimi i shoqërisë.

Neni 11

Shoqëria tregtare "CANI NDËRTIM" SHPK deklarohet e krijuar në zbatim të plotë të normave të statutit dhe në përputhje me kërkesat e legjisacionit shqiptar në fuqi.

Ky akt themelimi u përpilua në gjuhën shqipe dhe miratohet prej Ortakut të Vetëm duke u nënshkruar si më poshtë:

THEMELUESI I SHOQËRISË TREGTARE

"CANI NDËRTIM" SHPK

ORTAKU I VETËM

Niko CANI

NIKO CANI
